

KUVENDI I KOMUNËS SË PRIZRENIT  
Asambleja Komunale  
Nr. 01/06  
Më datën, 2 V 2002  
Prizren

Asambleja Komunale në mbledhjen e vet të mbajtur, më datën 2 V 2002, duke shqyrtuar propozimin e Vendimit të Planit Detal Urbanistik për Lagjen “ Bazhdaranë”, e në bazë të propozimeve të bëra gjatë diskutimeve në lidhje me këtë propozim, mori këtë

## K O N K L U Z I O N

Që gjatë realizimit të Vendimit të aprovuar të Planit Detal Urbanistik të Lagjesë “Bazhdaranë” me ndërtimin e objekteve të parapara me këtë Planë, që:



I Në mënyrë më racional e me qëllim të shfrytëzimit maksimal të sipërfaqesë së paraparë me këtë Planë, për ndërtimin e objekteve banesore e lokaleve afariste, të jetë ashtu, që do të ngritet infrastruktura e nevojshme bashkohore ( rregullimi për rreth objekteve të ngritura, autoparkingu etj) për nevojat e banusve që do të jenë në këto objekte.

II Gjatë dhënjes-shitjesë të lokaleve afariste në këto objekte që do të ndërtohen, do të mbrohen maksimalishtë interesat e pronarëve legal të objekteve të përkohshme (që i kanë vendosur objektet e përkohëshme në bazë të lejeve përkatëse të organeve kompetente komunale) të vendosura në ngastrat kadastrale të parapara në PDU-ik, për Lagjen “ Bazhdarana, e që janë pronë e Komunës.

III Për zbatimin e këtij Konkluzioni do të kujdesen: Drejtoria për Planifikim, Urbanizëm, Ndërtim, Rindërtim e Zhvillim e Drejtoria për Çështje Pronëso-ro-Juridike, Gjeodezi e Kadastër.

IV Ky Konkluzion hyn në fuqi në ditën e aprovimit dhe do të shpallet në “ Kumtar “

Kryeshëfi Ekzekutiv  
Qamir Buzhala



Kryetari i Kuvendit  
Mr. Eqrem Kryeziu

